



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr. 31

Prishtinë, më 10 shtator 2018, në orën:10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Shqipe Pantina, Jasmina Zhivkoviç, Valon Ramadani, Adem Mikullovc, Imet Rrahmani, Arban Abrashi, Xhevahire Izmaçu, Rasim Selmanaj, Milaim Zeka dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje morën pjesë përfaqësuesit e KDI-së dhe “Ekonomia Online”.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Nait Hasani, kryetar i komisionit.

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Çështjet vijuese - agjenda e projektligjeve;**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Çështjet vijuese – agjenda e projektligjeve

Kryetari i komisionit, njoftoi anëtarët e komisionit për çështjet vijuese të punës së komisionit për sesionin vjeshtor si vijon:

- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-036 për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës - raporti me amendamente është në procedurë në komisionet e

përhershme. Pas shqyrtimit të raporteve të komisioneve të përhershme, Komisioni funksional do ta procedojë projektligjin me amendamentet e propozuara për miratim në seancë plenare.

- Raporti i Komisionit funksional, me amendamente në Projektligjin për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare, është proceduar në komisionet e përhershme dhe pas shqyrtimit të raporteve të komisioneve të përhershme, Komisioni funksional do ta procedojë projektligjin me amendamentet e propozuara për miratim në seancë plenare.

- Projektligjin nr.06/L-081 për qasje në dokumentet publike, është miratuar, në parim, në seancën plenare, më 23 korrik 2018, shqyrtimi dhe amendamenti nga Komisioni funksional.

Shqipe Pantina, propozoi që Projektligji për qasje në dokumentet publike dhe Projektligji për mbrojtjen e të dhënave personale, duhet të shqyrtohen njëkohësisht me Komisionin për Siguri.

- Projektligji nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, pritet miratimi, në parim, në seancë plenare.

- Projektligji për aderimin e Kosovës në marrëveshjen për themelimin e Shkollës Rajonale të Administratës Publike (ReSPA)- shqyrtimi i projektligjit në komision dhe procedimi i rekomandimit për miratim në seancë plenare.

- Raporti për gjendjen në shërbimin civil të Republikës së Kosovës për vitin 2017- shqyrtimi në komision dhe procedimi i rekomandimit për miratim në seancë plenare.

- Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, si Komision funksional, ka marrë iniciativë për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media, si dhe nismën ligjore për hartimin e Draftligjit për mediat në Kosovë.

3. Të ndryshme

Kryetari i komisionit, njoftoi anëtarët e komisionit me ftesën e ministrit të Ministrisë së Administratës Publike, z. Mahir Yagcilar, për takim pune, të mërkurën, më datë 12 shtator 2018, për të diskutuar pakon legjislative të reformës së administratës publike, përkatësisht Projektligjin për pagat, Projektligjin për zyrtarët publikë, si dhe Projektligjin për administratën shtetërore dhe agjencitë.

Mbledhja përfundoi në orën 10:40.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Nait Hasani